

VENDIM Nr. 352, datë 26.5.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1090, DATË 24.12.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR FUNKSIONIMIN E
REGJISTRIT TË PRONARËVE PËRFITUES,
PËR MËNYRËN E KOMUNIKIMIT NË FORMË ELEKTRONIKE DHE SHKËMBIMIT
TË TË DHËNAVE NDËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
DHE ORGANEVE PËRGJEGJËSE SHTETËRORE, SI DHE PËR MËNYRËN
E AFATET E KOMUNIKIMIT MES REGJISTRIT TË PRONARËVE PËRFITUES,
REGJISTRIT TREGTAR DHE REGJISTRIT TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7; 7, pika 9; 13, pika 7; e 14, pika 3, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1090, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Kreu II ndryshohet, si më poshtë vijon:

**“II. RREGULLAT PËR MËNYRËN E TRANSFERIMIT TË TË DHËNAVE NGA
REGJISTRI TREGTAR DHE REGJISTRI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE**

1. Të dhënat e përgjithshme për subjektin raportues, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse transferohen automatikisht në mënyrë elektronike, nëpërmjet ndërveprimit të këtyre bazave të të dhënave shtetërore, si të dhëna dytësore në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

2. Në përputhje me pikën 1, të nenit 15/1, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, regjistrimi fillestar i të dhënave për pronarët përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese, të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi direkte, kryhet sipas parashikimeve vijuese të këtij kreu.

3. QKB-ja identifikon subjektet raportuese ekzistuese, të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi direkte, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 6/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, ‘Për regjistrin e pronarëve përfitues’, të ndryshuar”, nuk kanë përmbushur detyrimin për

regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues.

4. QKB-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, brenda datës 30.6.2022, nga baza e të dhënave ekzistuese në Regjistrin Tregtar transferon në Regjistrin e Pronarëve Përfitues të dhënat e pronarëve përfitues që identifikohen sipas përcaktimeve ligjore, në lidhje me subjektet e përcaktuara sipas pikës 3, të këtij kreu.”.

b) Pika 3, e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Me marrjen e njoftimit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, e deri në pagimin e saj dhe kryerjen e regjistrimit të detyrueshëm, QKB-ja ose autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse zbaton masat e parashikuara nga neni 13, i ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.”.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Botuar ne F.Zyrtare 81/2022

Dale nga shtypi me 31.05.2022